




REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO			
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT			
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE			
ANTI-CORRUPTION AGENCY			
Dep.		Nr. Prot.	
Dep.	2-0/DPK	Br. Prot.	01-1992/13
Dep.		Prot No.	
Nr. i faq.		Data	
Broj stranica	02	Datum	20.06.2013
Nr. pages		Date	
PRISHTINE			



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosova**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE**  
**ANTI - CORRUPTION AGENCY**

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika e) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 12.06.2013, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

**I. Mbyllët rasti më nr. AKK-03-474\13, për zyrtarin e lartë z. Arton Shabani, Auditor i Brendshëm në Ndërmarrjen Publike “Hortikultura”- Prishtinë, për shkak se zyrtari i lartë publikë ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.**

**II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

**A r s y e t i m**

**I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të mundshëm të interesit është zhvilluar procedura e parapare sipas nenit 18.1 dhe 18.2 të ligjit Nr.04/L-051, Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik.**

Pas identifikimit të rastit, ka filluar shqyrtimi i lëndës me numër protokollit AKK-03-474/13, që për trajtim ka pasur zyrtarin e lartë z. Arton Shabani, Auditor i Brendshëm në Ndërmarrjen Publike “Hortikultura”- Prishtinë, ku është dyshuar për gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit, pasi që ushtron edhe pozitën e personit të autorizuar në bizneset private “Cowana Sh.P.K” në Prishtinë.

Agjencia kundër Korrupsionit me datën 24.03.2013, e ka njoftuar zyrtarin e lartë me shkresën e parë se ka filluar procedurën e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejtë në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet që posedon Agjencia.

Pas këtyre procedurave, zyrtari i lartë z. Arton Shabani, pasi ka kontaktuar me zyrtarët e Agjencisë ka kërkuar të takohemi dhe të bisedojmë rreth çështjes së ngritur, sipas procedurës është organizuar takimi me z. Shabani me datën 13.05.2013, ku dhe i kemi shpjeguar për fillimin e hetimeve lidhur me konfliktin e mundshëm të interesit në ushtrimin e funksionit publik. Gjatë takimit zyrtari në fjalë e ka potencuar se ushtron funksionin e Auditorit i

Brendshëm në Ndërmarrjen Publike “Hortikultura”- Prishtinë dhe është person i autorizuar në biznesin private “Cowana Sh.P.K” ne Prishtinë.

Gjatë takimit zyrtari në fjalë ka pranuar dëshmitë e AKK-së dhe është zotuar se do te mundohet qe ne afat sa me te shpejtë do te bëjë ndryshimet dhe do të japë dorëheqje nga pozita e personit te autorizuar dhe do ta shmangë çfarëdo situatë qe mundë te shkaktoj konflikt të interesit.

Pas këtij takimi zyrtari i lartë z. Arton Shabani, ka sjellë ne Agjenci dëshmitë e lëshuara nga ARBK-ja, ku dëshmon se është tërhequr nga të qënurit person i autorizuar ne këtë biznes.

Duke u bazuar ne dëshmitë e ofruara nga zyrtari i lartë konstatojmë se : zyrtari i lartë z. Arton Shabani, Auditor i Brendshëm ne Ndërmarrjen Publike “Hortikultura”- Prishtinë, ka shmangur gjendjen e mundshme te konfliktit te interesit ne te cilën ndodhej.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari ndihmës)

Hasan Preteni  
Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

